



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI " FAN S . NOLI "  
KORÇË**

**RREGULLORE  
PËR  
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E QENDRËS RINORE DHE SPORTIVE TË UNIVERSITETIT  
“FAN S. NOLI”**

(Miratuar me Vendimin nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2017, të Senatit Akademik të UK-së)

## **PËRMBAJTJA**

Neni 1. Statusi.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 2. Misioni i QRS-së.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 3. Organizimi dhe drejtimi i QRS-së.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 4. Objektivat e QRS-së.....	Error! Bookmark not defined.
Neni 5. Detyrat e QRS-së.....	4
Neni 6. Përgjegjësi i QRS-së .....	Error! Bookmark not defined.

## **Neni 1** **Statusi**

1. Qendra Rinore dhe Sportive (më tej QRS) është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës (më tej UK) dhe është në varësi të Rektorit.
2. Organizimi, funksionimi, si dhe veprimtaria e QRS-së, bazohen në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe në Statutin, rregulloret dhe aktet e brendshme të UK-së.

## **Neni 2** **Misioni i QRS-së**

Misioni i QRS-së është krijimi i një mjedisi mbështetës për të nxitur, vlerësuar dhe promovuar aftësitë e studentëve në fusha të ndryshme shoqërore si arti, kultura, edukimi, sporti etj., si dhe forcimi i bashkëpunimit social midis të rinjve studentë brenda universitetit, në komunitetin lokal, si dhe midis grupeve të tjera të të rinjve, brenda dhe jashtë vendit.

## **Neni 3** **Organizimi dhe drejtimi i QRS-së**

1. QRS-ja drejtohet nga përgjegjësi i qendrës, i cili përgjigjet për:
  - Drejtimin dhe administrimin e QRS-së.
  - Organizimin, funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve rinore e sportive të studentëve të universitetit, si edhe për cilësinë dhe efektivitetin e këtyre veprimtarive.
  - Zbatimin e programeve për aktivitetet rinore, të miratuara nga Rektori.
2. QRS-ja do të zhvillojë veprimtarinë e saj, duke koordinuar punën me njësitë rinore që do të krijohen në fakultete. Lidhja e QRS-së me njësinë rinore të çdo fakulteti do të jetë vertikale për organizimin dhe promovimin e aktiviteteve të studentëve. Në çdo njësi rinore të fakulteteve, do të zgjidhet një student si përgjegjës për njësinë. Çdo njësi rinore e fakultetit do të ketë një bazë të dhënash të studentëve, ku të shënohen emri, mbiemri, adresa e email-it, numri i kontaktit dhe programi i studimit.

## **Neni 4** **Objektivat e QRS-së**

Në bashkëpunim me fakultetet, studentët dhe personelin ndihmësakademik dhe administrativ, funksionimi i QRS-së konsiston në përmbushjen e disa objektivave, si vijon:

- Nxitjen e pjesëmarrjes së rinisë studentore (studentëve) në zhvillimin e veprimtarive kulturore në fushën e letërsisë, artit, muzikës, etj., si dhe të atyre sportive.
- Nxitjen e aftësive në diversitetin e jetës sociale, të studentëve, nëpërmjet mbështetjes së grupeve rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër etj.)

- Nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së studentëve në kulturën sportive, me synim mbrojtjen e shëndetit të të rinjve studentë, përmes shtimit të aktiviteteve sportive.
- Krijimin e mundësive për shkëmbime dhe bashkëpunime me organizata apo qendra rinore në rajon e më gjerë.
- Kultivimi dhe nxitja e frymës së vullnetarizmit të studentëve, përmes zhvillimit të aktiviteteve dhe veprimtarive me kontribut vullnetar.
- Krijimi i infrastrukturës mbështetëse për mirëfunksionimin e qendrës dhe efektshmërinë e saj tek rinia studentore.
- Krijimin e disa grupeve apo klubeve të studentëve, mbështetur në fushat e shfaqjes së aftësive dhe interesit të tyre (klubi i letërsisë; klubi i artit (pikturë, fotografi); klubi i sportit (futboll, basketboll, volejball etj.); klubi i vullnetarëve (mjedis, trashëgimi, etj.).
- Mbështetjen e inicimit dhe zhvillimit të veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike dhe sportive, në zbatim të pikës 5, të nenit 99, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- Ndihma në aplikimin e studentëve për pajisjen me kartën e studentit, në bazë të kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit, të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

## Neni 5

### Detyrat e QRS-së

Qendra Rinore dhe Sportive ushtron veprimtarinë e saj brenda universitetit dhe është përgjegjëse për:

- Zhvillimin e veprimtarive rinore, kulturore, artistike, letrare, e sportive në funksion të zbatimit edhe të politikave rinore të zbatuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve si edhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Përgjegjësi i qendrës krijon dhe disponon një database të plotë mbi numrin dhe të dhënat e të gjithë studentëve të qendrës rinore të universitetit.
- Krijimin i mjedisit të përshtatshëm për organizimin e punës në qendër.
- Specifikimi i fushave të veprimit (secila nga këto mbulon disa aktivitete). Kulturë, art dhe sport (kulturë dhe kreativitet), shërbime studentore (karta e studentit me lehtësira në shërbimet mjeksore, shërbime transporti, kimema, shërbime vullnetare në komunitet etj.
- Angazhimi në organizimin dhe funksionimin e grupeve apo klubeve rinore të qendrës. Përkrahja e çdo iniciative dhe ideje të klubeve për aktivitete dhe veprimtari në përmbushje të misionit dhe objektivave të qendrës rinore dhe sportive.

- Zhvillimin dhe rritjen e bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit (me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Bashkinë e qytetit të Korçës, OJF të ndryshme rinore etj.)

**Neni 5**  
**Përgjegjësi i QRS-së**

1. Përgjegjësi i QRS-së përgjigjet për:
  - drejtimin, administrimin dhe funksionimin e qendrës, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarive.
  - hartimin dhe zbatimin e rregullores dhe programeve të veprimtarive që miratohen nga Rektori.
  - organizmin e takimeve, aktiviteteve, fushatave sensibilizuese për përfshirjen e të rinjve studentë në jetën sociale dhe kulturore.
2. Përgjegjësi i QRS-së emërohet dhe shkarkohet nga Rektori.

**MIRATUAR**

**SENATI AKADEMIK**

**KRYETARI**

**Prof. dr. ALI JASHARI**